

STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE “DAtelier Beauty” SH.P.K.

NENI 1
KRIJIMI I SHOQËRISË

1. Sot më datë 29/08/2025 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “DAtelier Beauty” shpk, (Në vijim referuar si “Shoqëria”) nga ortakët me të dhëna si vijon:
 - DAJANA QOSHJA, shtetase shqiptare, lindur më 14/12/1996 në Kruje, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, banuese në Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J66214039M.

Dhe

 - ALTEA NOKA, shtetase shqiptare, lindur më 03/11/1999 në Tirane, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, banuese në Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J96103060V.
2. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.
3. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

NENI 2
FORMA E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Asambleja e Përgjithshme e kësaj shoqërie nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhës nga dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar dhe këtij Statuti.

NENI 3
EMËRTIMI

1. Emërtimi i shoqërisë është “DAtelier Beauty” sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet sh.p.k.

NENI 4
SELIA E SHOQËRISË



1. Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga "Margarita Tutulani, Ap. Nr. 4, ZK 8270, vol. 56, fq. 29, nr. pasurie 7/319-N4, Tiranë.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së selive sekondare, filialeve, degëve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 5

KOHËZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.
2. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj në çdo kohë kur Asambleja e Përgjithshme e shih të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6


OBJEKTI I VEPRIMTARISË

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
 - Ofrimi i shërbimeve profesionale në fushën e make-up-it dhe kujdesit estetik;
2. Përveç aktiviteteve të parashikuara më lart, në veprimtarinë e Shoqërisë do të përfshihet çdo veprimtari tjetër që nga Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme për të përmbushur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk ndalohej nga ligji.
3. Aktivitetet e Shoqërisë, për të cilat kërkohet paraprakisht një leje, licencë, autorizim apo ndonjë akt tjetër miratues, do të ushtrohen pasi të jete marrë akti në fjalë.

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njqindmije) lekë.
2. Shoqëria përbëhet nga dy ortakë, me të dhënat e mëposhtme:
 - Dajana Qoshja, shtetase shqiptare, lindur më 14/12/1996 në Kruje, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, banuese në Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J66214039M, zotërues i 1 (një) kuote, në vlerën 50,000 lekë, në masën 50% të kapitalit;
 - Altea Noka, shtetase shqiptare, lindur më 03/11/1999 në Tirane, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, banuese në Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J96103060V, zotërues i 1 (një) kuote, në vlerën 50,000 lekë, në masën 50% të kapitalit.



3. Pjesëmarrja e ortakëve në shoqëri është e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i Ortakut	Kuota	Vlera	Përqindja %
1.	DAJANA QOSHJA	1	50,000 lekë	50
2.	ALTEA NOKA	1	50,000 lekë	50
TOTALI		2	100,000 lekë	100

4. Kapitali mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme bazuar në nevojat e shoqërisë dhe konform parashikimeve ligjore.
5. Kapitali është shlyer tërësisht nga ortakët.

NENI 8

ZMADHIMI I KAPITALIT TE SHOQËRISË

1. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, kurdo dhe më shumë se një herë, përmes kontributit në para apo në natyre apo në kredi, në zbatim të dispozitave ligjore.

NENI 9


ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

1. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me Vendim të Asamblesë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.
2. Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 10

MËNYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit;
 - Çdo mënyre tjetër parashikuar në ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata.




3. Kontrata për transferimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përben kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.
4. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

NENI 11

E DREJTA E PARABLERJES

1. E drejta e pronësisë mbi kuotat është e transferueshme por kufizohet nga e drejta e parablerjes së tyre nga ortaku tjetër i shoqërisë.
2. Ortaku që dëshiron të shesë kuotën duhet ta ofrojë atë së pari tek ortaku tjetër. Afati që ortaku tjetër duhet të vlerësojë ofertën është brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së ofertës.
3. Oferta duhet të dërgohet në formë të shkruar (postë rekomande) ose në formë elektronike (email), në adresën e secilit ortak të regjistruar pranë shoqërisë.
4. Oferta duhet të përmbajë datën, adresën e saktë të ortakut që i drejtohet, numrin e kuotave që kërkon të disponojë, cmimin e ofruar për kuote, monedhën (nëse është ndryshe nga ajo e kapitalit të regjistruar të shoqërisë), kursin e këmbimit dhe kushtet e shitjes nëse ka.
5. Nëse ortaku tjetër i shoqërisë e pranon ofertën në kushtet e parablerjes, ai duhet të shprehet qartë dhe hapur për vullnetin e tij të lirë dhe të pakushtëzuar në pranimin e ofertës.
6. Në rast se ortaku tjetër brenda 60 ditëve kalendarike refuzon ofertën ose nuk shprehet fare në lidhje me të, atëherë procedura e parablerjes konsiderohet e kryer dhe ortaku shitës është i lirë që të shesë kuotat e tij jashtë shoqërisë me një vlerë të barabartë ose më të madhe se ajo e paraqitur në ofertë.
7. Në cdo rast, asambleja duhet të miratojë shitjen e kuotave jashtë shoqërisë me shumicë të cilësuar.
8. Ndalohet shitja dhe/ose dhurimi i kuotave ndaj personave fizike apo juridike veprimtaria e të cilëve duket hapur që dëmton veprimtarinë e shoqërisë "DAtelier Beauty" sh.p.k..



NENI 12

PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të nenit 74 të Ligjit Për shoqëritë tregtare.
2. Shoqëria realizon kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".


NENI 13

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME TË DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet sipas ligjit dhe statutit, por pa u kufizuar në:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
 - d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Për miratimin e marrjes së audituesve të jashtëm, në rastet e hetimeve të posacme;
 - l) Shpërndarjen e fitimeve për ortakët;
 - m) Shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërish;
 - n) Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe rregulloreve të tjera që në thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së shoqërisë;
 - o) Miratimin në rastin e shitblerjes së kuotave të ortakëve ose formave të tjera të transferimit të tyre, sipas parashikimeve të këtij statuti.

NENI 14

MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME



1. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji për shoqëritë tregtare, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën 1 herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori dhe/apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Nr. 9901, dt. 14.04.2008 të ndryshuar.

NENI 15

MËNYRA E THIRRJES

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë poste rekomande ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike në adresat e deklaruara të ortakëve. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Në rast se ortakët ndryshojnë të dhënat e adresës fizike apo asaj elektronike, duhet të njoftojnë adresat e reja brenda 5 ditëve tek administratori i shoqërisë. Në rast se ortakët nuk njoftojnë për ndryshimet e adresave dhe njoftimet për mbledhjet e asamblesë shkojnë në adresat e vjetra, do të konsiderohet se ata janë njoftuar rregullisht.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm në mbledhje dhe janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 16

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure të posacme nga një person i tretë. Në cdo rast përfaqësimi të një apo disa ortakëve, drejtuesi i mbledhjes së asamblesë duhet të verifikojë ligjshmërinë e autorizimit të përfaqësimit. Përfaqësuesit e autorizuar do të pranohen në mbledhje vetëm nëse autorizimi i tyre plotëson kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar mbi përfaqësimin.
2. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 17

KUORUMI

PËR VENDIMET ME SHUMICË TË ZAKONSHME



1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë) të kuotave.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet, për shkak të mungesës së kuorumit në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 18


KUORUMI PËR VENDIMET ME SHUMICË TË KUALIFIKUAR

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja merr vendim me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës kur marrin pjesë në mbledhje ortakët e shoqërisë me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë) të kuotave të shoqërisë, në rastet e mëposhtme:
 - a) për ndryshimin e statutit,
 - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
 - c) shpërndarjen e fitimeve,
 - d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

NENI 19

E DREJTA E VOTËS

1. Cdo ortak ka të drejtë vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.
2. Ortakët që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja e asamblesë së përgjithshme, kanë të drejtë që të përfaqësohen ose të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet plotësisht identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a. transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b. komunikimin e ndërsjelltë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
 - c. mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Nëse gjatë zhvillimit të mbledhjes ndodh që të ndërpritet komunikimi mes ortakut/ve me mbledhjen për arsye teknike apo të forcave madhore, dhe ortaku apo




ortakët nuk kanë përfaqësuesit e tyre fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja, atëherë vendimmarrja do të konsiderohet e rregullt për atë kohë sa ishte vendosur lidhja e drejtpërdrejtë me mbledhjen me ortakun dhe/ose ortakët, gjë e cila duhet shënuar në procesverbalin e mbledhjes.

NENI 20

ADMINISTRATORI

EMËRIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Përgjithshme merr vendim të posaçëm për riemërimin e Administratorit pas periudhës së emërimit të parë.
2. Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë dhe drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke siguruar që menaxhimi i Shoqërisë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, Administratori ka të drejtën të nënshkruajë të gjithë aktet dhe dokumentat e Shoqërisë, përfshirë hartimin e të gjitha vendimeve të Shoqërisë.
3. Caktimi i Administratorit bëhet nga ky statut për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë riemërimi nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i shoqërisë caktohet DAJANA QOSHJA, shtetase shqiptare, madhore me zotësi për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. personal J66214039M.
4. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
 - a. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. Hapë llogari bankare në emër të shoqërisë;
 - e. Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, dhe i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - f. Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - g. Kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;



- h. Raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- i. Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- j. Të thërrasë asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose Ligji për shoqëritë tregtare.

NENI 21

EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

1. Nëse kërkohet nga ligji apo një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një apo më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.
2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të revokohet në çdo rast në bazë të kushteve të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

NENI 22

VITI FINANCIAR, BILANCI, KONTABILITETI

1. Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të çdo viti. Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.
2. Bilanci dhe raporti i ecursisë i hartuar prej Administratorit dhe raporti që, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar sipas rastit, miratohen prej Asamblesë së zakonshme me shumicën të thjeshtë.
3. Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

NENI 23

FITIMET

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë sipas përqindjes së pjesëmarrjes në shoqëri, pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë dhe të miratuara nga një ekspert kontabël i miratuar dhe prej asamblesë së ortakëve me vendim. Shoqëria mund të mos ndajë fitim edhe kur realizon fitim, nëse mbledhja e asamblesë ka vendosur për këtë qëllim.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitim ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a. Aktivët e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;



- b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12-muajve në vazhdim.
3. Asambleja, gjithashtu, mund të vendosë të mbajë shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve - tërësisht apo pjesërisht - në vitet ushtrimore pasardhëse.

NENI 24

SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmerisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm;
- për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - d) në rastet e pavlefshmerisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit tregtar;
 - e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - f) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - g) për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara më sipër, vendoset nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

NENI 25

LIKUIDIMI

1. Në rast të prishjes së Shoqërisë apo ekzistencës së ndonjë rrethane tjerër që dikton të nevojshëm likuidimin, Asambleja do të nisë procedurat e likuidimit sipas parashikimeve përkatëse të ligjit Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

NENI 26

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Statuti dhe mes Shoqërisë dhe ortakëve, administratorit dhe ortakëve apo mes vet ortakëve, do të jenë nën kompetencën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 27

DISPOZITA TË FUNDIT



1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut që lidhet me funksionimin e shoqërisë, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij stauti.
2. Në çdo rast kur legjislacioni shqiptar përkatës mund të ndryshojë, ky statut me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas rregullave të përcaktuara mund të ndryshohet, në përputhje me ndryshimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.
3. Caktohet administratori i shoqërisë ose një person i autorizuar prej këtij të fundit për regjistrimin fillestar të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
4. Ky statut hartohet në 4 kopje origjinale, nënshkruhet sot më 29/08/2025 dhe prodhon efekte ndaj të tretëve nga data e regjistrimit të tij në QKB.

ORTAKËT E SHOQËRISË



DAJ ANQOSHJA



AL TENOKA